



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE
JURIDIKE

Nr. 2101 prot.

Tiranë, më 28.09.2020

URDHËR

Nr. 65, datë 28.09.2020

“PËR
MIRATIMIN E MODELIT TË FORMULARIT TË ANKESËS”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, bazuar në nenin 119, pika 8, dhe nenin 120, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të formularit të ankesës sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij urdhri.
 2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për publikimin në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të modelit të formularit të ankesës.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË ANKESËS

I nderuar ankues,

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një institucion kushtetues, i cili është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Shkeljet disiplinore hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.

Qëllimi i hartimit dhe publikimit të udhëzimit për plotësimin e ankesës është të ndihmojë ankuesin në përgatitjen dhe paraqitjen e saj pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë kuadër, lutemi nga ana juaj të plotësoni saktë formularin e ankesës, duke ndjekur udhëzimet e mëposhtme.

UDHËZIME

1. Sipas kërkesave të nenit 120, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ankesa juaj duhet të jetë në formë të shkruar.
2. Ju mund të paraqisni ankesën tuaj, duke plotësuar formularin e ankesës. Formulari i ankesës mund të plotësohet me shkrim dore ose me kompjuter. Nëse e plotësoni me shkrim dore, ju lutemi të përdorni shkronja shtypi, në mënyrë që teksti të jetë i lexueshëm.
3. Plotësoni të gjithë informacionin e kërkuar në rubrikat përkatëse. Në të njëjtën kohë, formulari i ankesës përmban edhe rubrika opsionale për të cilat ju mund të mos jepni informacion. Nëse nuk jepni informacion në këto rubrika, nuk jeni të detyruar të jepni arsyet pse nuk jepni informacion. Vëmendje të veçantë kërkojnë rubrikat, të cilat pasqyrojnë të dhëna lidhur me subjektin dhe objektin e ankesës.
4. Mbani parasysh se Inspektori i Lartë i Drejtësisë (I.L.D.) është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për të vlerësuar fillimin e

procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve/prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, por jo të personelit të shërbimit civil gjyqësor/prokurorisë, të cilët janë personat që ushtrojnë funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor/prokurorisë ose administrativ të një gjykate/prokurorie.

5. Pasqyroni në mënyrë të saktë të dhënat tuaja apo të përfaqësuesit tuaj, si dhe adresën tuaj e cila do të shërbejë për komunikimin ndërmjet jush dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Adresa e deklaruar nga ana juaj në formularin e ankesës duhet të jetë e saktë dhe e plotë pasi nëpërmjet saj do të njoftoheni mbi çdo veprim administrativ zyrtar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë shqyrtimit të ankesës suaj.

6. Pasqyroni në mënyrë të saktë emrin e subjektit ndaj të cilit ankoheni dhe institucionin ku ushtron detyrën. Parashtroni në mënyrë të saktë faktet në lidhje me shkeljen e pretenduar të gjyqtarit/prokurorit, të një prej anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, apo Prokurorit të Përgjithshëm. Në formularin e ankesës identifikoni sa mundeni nëse shkelja disiplinore e pretenduar lidhet me ushtrimin e funksionit, është kryer jashtë ushtrimit të funksionit apo për shkak të kryerjes së një vepre penale. Ky informacion do të ndihmojë Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga ana juaj në mënyrë sa më të shpejtë dhe në përputhje me procedurat dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. Ju lutem vini re, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (I.L.D) nuk ka asnjë autoritet të shqyrtojë çështje të cilat mund të kontrollohen nëpërmjet procedurave të ankimit në një gjykatë të shkallës më të lartë. Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (I.L.D) nuk ka asnjë autoritet të ndikojë mbi gjykatën/prokurorinë që ju të përfitoni një rezultat të ndryshëm në çështjen tuaj. Nëse keni për qëllim të ndryshoni rezultatin e çështjes tuaj, diskutojeni këtë pa vonesë me një avokat.

8. Bashkëlidhni të gjitha dokumentet e nevojshme, të cilat sipas mendimit tuaj vërtetojnë deklaratimet e fakteve të bëra në ankesë. Ju lutem jepni të dhëna se ku mund të gjendet informacioni i nevojshëm.

9. Vendosni datën dhe nënshkrimin në ankesë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (I.L.D) do të respektojë në mënyrë rigorozë të gjitha detyrimet e tij ligjore në lidhje me konfidencialitetin.

10. Dërgoni ankesën së bashku me dokumentet e bashkëlidhura në adresën e mëposhtme postare, ose adresë elektronike: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina 13, Tiranë, <http://www.ild.al>, Email: info@ild.al.

VINI RE: Ankesat e dërguara në adresë të gabuar mund të mos trajtohen.

11. Ankesa juaj mund të paraqitet në mënyrë elektronike me e-mail, FAX, nëpërmjet postës ose drejtpërdrejtë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D).

12. Ju lutem kini parasysh se tërheqja e ankesës nga ana juaj nuk ndërpret procesin e shqyrtimit të saj nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

13. Ankesat dhe dokumentet e bashkëlidhura nuk do të kthehen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ANEKS NR.1

FORMULARI I ANKESËS

I.

INFORMACION MBI TË DHËNAT PERSONALE TË ANKUESIT			
Emri/Mbiemri i ankuesit: Emri/Mbiemri i personit juridik:			
Nr. Personal/Shtetësia:			
Emri/Mbiemri i Përfaqësuesit të personit juridik:			
Adresa e përhershme:			
Adresa për korrespondencën (nëse është e ndryshme nga adresa e përhershme)			
Adresa elektronike (e-mail)			
Numrat e telefonit	Nr. fiks:	Punë/Zyrë:	Celulari:
Forma e ankesës	<input type="checkbox"/> Me postë elektronike <input type="checkbox"/> Me postë të rregullt		<input type="checkbox"/> Personalisht <input type="checkbox"/> Faks
Konfidencialiteti i identitetit	Kërkoni të ruani konfidencialitetin e identitetit tuaj? Po <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Jo		

II.

INFORMACION MBI TË DHËNAT E SUBJEKTIT

Subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa:

- Gjyqtar
- Prokuror
- Anëtar KLGJ
- Anëtar KLP
- Prokuror i Përgjithshëm

Emri dhe mbiemri i subjektit: _____

Gjykata/Prokuroria në të cilën gjyqtari/prokurori ushtron ose ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar:

III.

OBJEKTI I ANKESËS

Shkelja disiplinore e pretenduar është:

- në lidhje me ushtrimin e funksionit
- jashtë ushtrimit të funksionit
- për shkak të kryerjes së veprës penale

Cila është ankesa juaj?

(Ju lutemi jepni detaje mbi faktet, rrethanat dhe datën se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar)

IV.

OPSIONALE		
Nëse ankesa juaj ka lidhje me çështje gjyqësore/nën hetim, ju lutemi plotësoni informacionin përkatës në fushat e mëposhtme. Nëse jo, vazhdoni me plotësimin e pjesës IV		
INFORMACION NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN		
Numri i çështjes		
Lloji i çështjes Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse!	<input type="checkbox"/> Civile <input type="checkbox"/> Administrative <input type="checkbox"/> Penale	
Përfshirja e ankuesit në çështjen e lartpërmendur: Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse!	<input type="checkbox"/> Padi tës <input type="checkbox"/> I paditur <input type="checkbox"/> I pandehur <input type="checkbox"/> Ankues <input type="checkbox"/> Avokat <input type="checkbox"/> Dëshmitar <input type="checkbox"/> Tjetër Nëse tjetër, ju lutem specifikoni _____	
Faza aktuale e procesit	<input type="checkbox"/> Në gjykim <input type="checkbox"/> Pas gjykimit <input type="checkbox"/> Gjykata e Shkallës së Parë _____ <input type="checkbox"/> Gjykatë Apeli _____ <input type="checkbox"/> Gjykatë e Lartë <input type="checkbox"/> Nën hetim <input type="checkbox"/> Prokuroria e Shkallës së Parë _____ <input type="checkbox"/> Prokuroria e Apelit _____	
A jeni ankuar më parë për të njëjtat fakte?	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
	Numri i regjistrimit i ankesës	

Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse dhe parashtroni të dhënat e kërkuara!	dhe/ose numri i çështjes tek Zyra e Inspektorit: 	
---	---	--

V.

OPSIONALE LISTA E DOKUMENTEVE BASHKËLIDHUR
<ol style="list-style-type: none"> 1. 2. 3. 4. 5. 6. 7.

VI.

KËRKESË E VEÇANTË, KONFIDENCIALTITETI
<p>Deklaratë konfidencialiteti</p> <p>Me anë të kësaj deklarate Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr përsipër të mos përdorë dhe të mos i transmetojë personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga ankuesi, përveç nëse autorizohet shprehimisht nga ky i fundit, ose kërkohet me ligj. Ky detyrim vlen për çdo fazë të shqyrtimit të ankesës.</p> <p>Përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga ligji nr.9987, datë 10.03.2008 për “Mbrotjtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk do të përdorë ose përhapë asnjë të dhënë personale që merr dijëni gjatë veprimtarisë së tij për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me veprimtarinë e tij.</p> <p>Në çdo rast informacioni i paraqitur konsiderohet konfidencial dhe do të përdoret vetëm nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D.) për qëllime të shqyrtimit të ankesës.</p>

Shënim: Nëse pjesë të caktuara të formularit janë të pamjaftueshme për deklarin e të dhënave, mund të shtoni pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

Data

Nënshkrimi i Ankuesit/
Përfaqësuesi i Ankuesit